



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 20

Tiranë – E hënë, 21 korrik 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Njoftim i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë nr. 152/1, datë 15.7.2025	Për bankat e nivelit të dytë për të paraqitur oferta për normën e interesit të kredisë studentore.....	3
Njoftim i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 8240/4, datë 11.7.2025	Për hapjen e procedurës së konkurrimit me objekt dhënien në përdorim të pasurisë kulturore publike Kalaja e Rozafës, Shkodër..	6
Njoftim i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 8241/3, datë 11.7.2025	Për hapjen e procedurës së konkurrimit me objekt dhënien në përdorim të pasurisë kulturore publike Kalaja e Lëkurësit, Sarandë..	9



NJOFTIM

Nr. 152/1, datë 15.7.2025

**PËR BANKAT E NIVELIT TË DYTË PËR
TË PARAQITUR OFERTA PËR
NORMËN E INTERESIT TË KREDISË
STUDENTORE**

Në mbështetje të nenit 11, pika 1/c, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të gremës “c”, të pikës 3 të VKM-së nr. 397, datë 3.5.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë”; si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 440, datë 19.7.2023, “Për përcaktimin e skemës së kreditimit studentor”, të ndryshuar:

Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) fton bankat e nivelit të dytë të interesuara të paraqesin ofertë për normën e interesit për kreditin studentor, sipas kushteve të skemës së kreditimit studentor, të përcaktuara në VKM-në nr. 440, datë 19.7.2023, të ndryshuar.

Sipas skemës së kreditimit studentor, studentët të cilët plotësojnë kushtet kanë të drejtë të përfitojnë kredi studentore për financimin e kostos së studimeve, ku një pjesë e normës së interesit të kredisë (jo më shumë se pesë pikë përqindjeje) do të financohet nga buxheti i shtetit.

Kreditimi i studentëve do të realizohet nga banka/bankat e nivelit të dytë, të cilat do të për zgjidhen me procedurë konkurrimi. Procedurat, rregullat e për zgjedhjes dhe të renditjes së bankave

të nivelit të dytë, si dhe procedurat e ankimit realizohen sipas Kodit të Procedurës Administrative. Të gjitha bankat e nivelit të dytë, për t’u kualifikuar duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta.

Renditja e ofertave të bankave do të bëhet nga komisioni i vlerësimit dhe i renditjes, që ngrihet nga AKFAL-ja, i cili do të rendisë ofertat e administruara, sipas normës më të ulët të interesit.

Për sa më sipër:

Ftojme çdo bankë të nivelit të dytë të paraqesë ofertën e saj, dorazi ose me postë, brenda **30 ditëve kalendarike nga data 21 korrik 2025.**

Ofertat paraqiten në zarf të mbyllur, të specifikuar për protokollin me shënimin: *“të mos hapet deri në datën e caktuar”*, në adresë të Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, *adresa: rruga “Naim Frashëri”, nr. 37, Tiranë.*

Dokumentet bashkëngjitur ofertës duhet të dorëzohen kopje origjinale ose të noterizuara, sipas anekseve më poshtë:

- Aneksi 1: Lista e dokumenteve të nevojshme për aplikim;
- Aneksi 2: Formulari tip i aplikimit;
- Aneksi 3: Deklarata për pranimin e kushteve të përcaktuara në VKM-në nr. 440/2023, të ndryshuar;
- Aneksi 4: Formulari tip i deklarimit të konfliktit të interesit.



ANEKS 1
LISTA E DOKUMENTEVE TË NEVOJSHME PËR APLIKIM

Përbën shkak skualifikimi, mungesa e dokumentacionit, sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta.

Kritere të përgjithshme të kualifikimit
Banka ofertuese duhet të paraqesë dokumentacionin vërtetues, si më poshtë: 1. Dokumentin e licencimit për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë nga Banka e Shqipërisë (kopje e noterizuar); 2. Ekstrakti nga Qendra Kombëtare e Biznesit; 3. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore për vitin 2025; 4. Formularin e ofertës sipas aneksit 2.
Kritere të veçanta të kualifikimit
1. Deklarata për dakordësinë mbi kushtet e parashikuara në VKM-në nr. 440/2023, të ndryshuar, sipas aneksit 3. 2. Deklaratë e bankës së nivelit të dytë mbi disponimin e infrastrukturës së nevojshme për ofrimin e shërbimit të disbursimit të kredisë studentëve menjëherë pas nënshkrimit të çdo marrëveshjeje midis bankës dhe studentit përfitues.

Bankat e nivelit të dytë duhet të dëshmojnë se i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, duke dorëzuar dokumentet përkatëse, sipas thirrjes publike.

Në rast të mosplotësimit të një prej kriterëve, aplikimi konsiderohet i paplotë dhe, si i tillë, nuk kualifikohet.

E drejta e ankimit mund të ushtrohet nga bankat e nivelit të dytë, brenda 5 (pesë) ditëve, nga data e njoftimit dhe shpalljes së renditjes nga Komisioni i Vlerësimit dhe Renditjes, në rrugë postare pranë AKFAL-së.

ANEKSI 2
FORMULARI TIP PËR APLIKIMIN E BANKAVE TË NIVELIT TË DYTË

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË BANKËS SË NIVELIT TË DYTË		
PËRFAQËSUESI LIGJOR:		
Numri i identifikimit personal të përfaqësuesit (sipas kartës së identitetit/pasaportës): _____		
Banka e nivelit të dytë _____	NIPT _____	Akti i licencimit Nr. _____, datë _____._____.____.
Adresa e selisë: _____		
Propozimi i normës së interesit për kredinë studentore: Norma vjetore fikse e interesit: (_____) % Vlera e shpenzimeve administrative bankare: (_____) në lekë Komisioni i disbursimit të kështit: (_____) në % ose në lekë. Normë efektive e interesit: (_____) %		
Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i/e vetëdijshëm, se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta, apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara, apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Autorizoj MAS-in dhe/ose AKFAL-në për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit tim. KËRKUESI _____ <i>Emri Mbiemri, nënshkrimi, vulë</i> E-mail: _____ Nr. cel: _____		



ANEKSI 3

DEKLARATË PËR PRANIMIN E KUSHTEVE TË PËRCAKTUARA NË VKM-në NR. 440/2023,
TË NDRYSHUAR

Deklaruesi: _____

Unë _____, në pozicionin _____ dhe përfaqësues ligjor i bankës së nivelit të dytë _____, deklaroj se Banka është dakord dhe pranon të jetë pjesë e skemës së kreditimit studentor, duke plotësuar kushtet e parashikuara në VKM-në nr. 440/2023, të ndryshuar, për kontratën bankë–student, e konkretisht:

- a) *Kredia studentore jepet pa kolateral fizik;*
- b) *Kredia studentore jepet për mbulimin e kostove vetëm për ndjekjen e një programi studimi;*
- c) *Financimi i kredisë bëhet me këste, të paktën dy herë në vit. Financimi i kështit të parë për çdo vit akademik duhet të realizohet pas konfirmimit nga institucioni i arsimit të lartë, që studenti kredimarrës ka frekuentuar procesin mësimor. Financimi i kësteve pasardhëse realizohet pas konfirmimit nga institucioni i arsimit të lartë, që studenti kredimarrës ka shlyer tarifën vjetore të shkollimit të atij viti akademik dhe ka frekuentuar procesin mësimor;*
- ç) *Shlyerja e detyrimeve financiare nga studenti kredimarrës fillon jo më herët se kohëzgjatja normale e programit të studimit, për të cilin studenti ka nënshkruar kontratën e kredisë, por me kërkesë të studentit kredimarrës, shlyerja e detyrimeve financiare mund të realizohet dhe para përfundimit të kohëzgjatjes normale të studimeve;*
- d) *Norma e interesit të kredisë studentore të jetë më e ulët se norma mesatare e interesit për kreditë konsumatore, të dhëna nga institucioni kredidhënës për 2 (dy) vjetët e fundit, përfshirë vitin në të cilin jepet kjo kredi;*
- dh) *Norma e interesit të kredisë të jetë e pandryshueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së kredisë.*

Nënshkrimi _____

Emri Mbiemri, nënshkrimi, vula

ANEKSI 4

FORMULARI I DEKLARIMIT TË KONFLIKTIT TË INTERESIT

Deklaruesi: _____

Unë, _____, në pozicionin e _____ dhe të përfaqësuesit ligjor të bankës së nivelit të dytë _____, deklaroj se nuk jam në kushtet e konfliktit të interesit, që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi, që mund të cenojnë zhvillimin e drejtë të procesit të përzgjedhjes së aplikimeve për financimin e normës së interesit.

Kjo deklaratë është hartuar më datë _____. 2025.

Nënshkrimi _____

Emri Mbiemri, nënshkrimi, vula

NJOFTIM

Nr. 8240/4, datë 11.7.2025

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË
KONKURRIMIT ME OBJEKT DHËNIEN
NË PËRDORIM TË PASURISË
KULTURORE PUBLIKE KALAJA
E ROZAFËS, SHKODËR**

1. Institucioni përgjegjës**Emri dhe adresa e institucionit përgjegjës:****Emri:** Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit**Adresa:** Rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Tiranë**Tel./Fax** +355696873335**E-mail dhe personi i kontaktit:** Benida Kraja, benida.kraja@meki.gov.al**Faqja e internetit:** www.meki.gov.al**2. Objekti:** Dhënie në përdorim të pasurisë kulturore publike.**2.1 Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** Dhënie në përdorim ambienti shërbimi në pasurinë kulturore Kalaja e Rozafës, Shkodër, monument kulture, kategoria e parë, me qëllim rijetësimi.**Burimi i financimit:** Nga burimet financiare të subjektit të shpallur fitues nga procedura konkurruese.**2.2 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:** deri në 20 (njëzet) vjet me të drejtë rinovimi.**2.3 Vendndodhja e objektit të konkurrimit:**Ambient shërbimi në oborrin e tretë të Kalasë së Rozafës, Shkodër, me sipërfaqe prej 196.2 m².

Kalaja gëzon statusin “pasuri kulturore” shpallur nga vendimi i Institutit i Shkencave (botuar në Gazetën Zyrtare nr. 95, datë 16.10.1948), Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës nr. 6, datë 15.1.1963, Ministria e Arsimit dhe Kulturës me nr. 1886, datë 10.6.1973, si dhe objekt i VKM-së nr. 788, datë 18.12.2024, “Për deklarimin “pasuri kulturore e paluajtshme” të zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Shkodrës, miratimin e zonifikimit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”.

Vendndodhja e pasurisë kulturore: lidhja 1.

3. Kriteret**3.1 Kriteret e konkurrimit****Personi fizik ose juridik**, që kërkon të marrë në përdorim një pasuri kulturore publike, duhet të përmbushë kriteret si më poshtë:**a) Personi fizik:**

i. të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e trashëgimisë kulturore;

ii. të jetë i regjistruar në regjistrat publikë;

iii. të mos jetë në procedura likuidimi dhe falimentimi;

iv. të ketë burimet e mjaftueshme financiare për marrjen në përdorim të pasurisë kulturore, publike, duke vërtetuar disponimin e kapaciteteve financiare për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e projektit;

v. të disponojë kapacitetet teknike dhe ligjore për të marrë përsipër përdorimin e pasurisë kulturore;

vi. të disponojë personelin e specializuar ose të sigurojë bashkëpunimin me persona të specializuar;

b) Personi juridik:

i. drejtuesi dhe/ose administratori të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e trashëgimisë kulturore;

ii. të ketë fituar personalitet juridik nëpërmjet regjistrimit në regjistrat publikë;

iii. të mos jetë në procedura likuidimi dhe falimentimi;

iv. të ketë burimet e mjaftueshme financiare për marrjen në përdorim të pasurisë kulturore publike, duke vërtetuar disponimin e kapaciteteve financiare për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e projektit;

v. të disponojë kapacitetet teknike dhe ligjore për të marrë përsipër përdorimin e pasurisë kulturore të paluajtshme, sipas formës së përdorimit të kërkuar;

vi. të disponojë personelin e specializuar ose të sigurojë bashkëpunimin me persona të specializuar.

Subjektet konkurruese, ndër të tjera, duhet të sigurojnë burime vjetore bazë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e vlerave të paluajtshme kulturore mbi bazën e pronës nën rijetëzim dhe, në rastet kur janë të pranishme vlerat arkeologjike ose të dhëna rreth vendeve arkeologjike apo objekteve, edhe burime për studimet arkeologjike, deri në eksplorimin e plotë të zonës së pranuar.

3.2. Për të provuar plotësimin e kriterëve të përgjithshme, subjektet e interesuara dorëzojnë dokumentacionin, si më poshtë vijon:



- a) vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore;
- b) ekstrakt historik të regjistrimit të subjektit në regjistrat publikë;
- c) dokumentacion financiar (vërtetim bankar i 3 (tre) muajve të fundit);
- ç) dokumentacion tatimor, sipas përcaktimeve të komisionit në varësi të projektit;
- d) dokumentacion teknik, sipas përcaktimeve të komisionit në varësi të projektit;
- dh) vërtetim nga tatimet për numrin e punonjësve.

4. Dokumentacioni

Dosja e dorëzuar, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 3, duhet të përmbajë dhe dokumentet specifike, si më poshtë vijon:

- i. propozimin për marrjen në përdorim të pasurisë kulturore;

- ii. projektin e rijetësimit, sipas nenit 185, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar;
- iii. analizën e detajuar të projektit;
- iv. planin e zhvillimit të territorit;
- v. dokumentacionin për pjesëmarrje në projekte të mëparshme;
- vi. garancinë për miradministrimin e pronës, në formën e një vërtetimi bankar, të 3 (tre) muajve të fundit nga data e dorëzimit të dokumentacionit, në vlerën jo më pak se 10 (dhjetë) % të projektit të propozuar;
- vii. vërtetim për xhiron mesatare vjetore të 3 (tre) vjetëve të fundit, në vlerën prej minimalisht 50 (pesëdhjetë) % të vlerës së investimit të parashikuar në projektin e propozuar.

5. Procedura

5.1. Lloji i procedurës:

Procedurë konkurruese për dhënie në përdorim me qëllim rijetëzimi	Procedurë konkurruese për dhënie në përdorim të drejtpërdrejtë
☒	☐

5.2 Kriteret e vlerësimit:

Për dhënien në përdorim të pasurisë kulturore publike me qëllim rijetësimi, përveç kriterëve si më lart, vlerësohet:

Nr.	Kriteri	Pikët
1	Plani i kryerjes së ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, në varësi të objektit të veprimtarisë (plani i veprimtarisë)	20
2	Niveli i investimit në raport me ruajtjen e promovimin e pasurisë kulturore	20
3	Cilësia e projektit të rijetësimit të propozuar, hartuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar	20

Pasuria kulturore publike jepet në përdorim, kur veprimtaria për të cilën jepet në përdorim:

Nr.	Kriteri	Pikët
1	Është në përputhje me funksionin dhe vlerat kulturore të pasurisë së miratuar, sipas vendimit të KKMPK-së	10
2	Promovon vlerat kulturore të pasurisë	10
3	Garanton shfrytëzimin e pasurisë kulturore në kuptim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe aksesin nga publiku	10
4	Ofron shërbime cilësore për publikun	10

5.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Dokumentacioni i kërkuar paraqitet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e botimit të njoftimit.

Data: 21.8.2025; Ora: 12:00

Vendi: Në ambientet e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Salla e Mbledhjeve, kati i katërt.

4.5 Gjuha/ët për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	☒	Shënim Dokumentacioni paraqitet në gjuhën shqipe, origjinal ose i njëzuar me origjinalin. Dokumentet nga shtetet e huaja paraqiten të legalizuara, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara sipas legjislacionit në fuqi.
-------	-------------------------------------	---

5. Informacione plotësuese**5.1. Shqyrtimi**

Komisioni shqyrton e vlerëson dokumentacionin e paraqitur brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit të dorëzimit.

Mungesa e dokumenteve që vërtetojnë plotësimin e ndonjërit prej kriterëve të përcaktuara në kreun II të vendimit nr. 857, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të konkurrimit, formën dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturore publike, sjell skualifikimin e subjektit të interesuar. Ky fakt konstatohet në relacionin përfundimtar të komisionit.

Procesi i vlerësimit vazhdon edhe kur është paraqitur së paku një propozim i vlefshëm. Propozim i vlefshëm konsiderohet propozimi që nuk mund të skualifikohet, sipas parashikimeve të këtij vendimi.


Komisioni bën vlerësimin e projektit dhe të elementeve të tjera të konkurrimit, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 857, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të konkurrimit, formën dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturore publike”.


5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për dorëzimin e dokumentacionit)

Subjektet e interesuara për të marrë pjesë në konkurrimin publik dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm pranë protokollit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ose me postë fizike, ose elektronike, në adresën info@meki.gov.al brenda datës 21.8.2025, ora: 12:00.

Ofertat do të hapen në ambientet e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Salla e Mbledhjeve, kati i katërt.

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi: **21.7.2025.**

Lidhja 1

**NJOFTIM**

Nr. 8241/3, datë 11.7.2025

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË
KONKURRIMIT ME OBJEKT DHËNIEN
NË PËRDORIM TË PASURISË
KULTURORE PUBLIKE KALAJA
E LËKURËSIT, SARANDË**

1. Institucioni përgjegjës**Emri dhe adresa e institucionit përgjegjës:****Emri:** Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit**Adresa:** Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Tiranë**Tel./Fax** +355 696873335**E-mail dhe personi i kontaktit:** Benida Kraja, benida.kraja@meki.gov.al**Faqja e Internetit:** www.meki.gov.al**2. Objekti:** Dhënie në përdorim të pasurisë

kulturore publike.

2.1 Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Dhënie në përdorim ambienti shërbimi në pasurinë kulturore publike, Kalaja e Lëkurësit, monument kulture, kategoria e parë, Sarandë, me qëllim rrijtësimi.

Burimi i financimit: Nga burimet financiare të subjektit të shpallur fitues nga procedura konkurruese.

2.2 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: deri në 20 (njëzet) vjet me të drejtë rinovimi.

2.3 Vendndodhja e objektit të konkurrimin

Ambient shërbimi në Kalanë e Lëkurësit, Sarandë, me sipërfaqe prej 862 m².

Kalaja e Lëkurësit ndodhet midis rrënojave të fshatit Lëkurës të braktisur në vitin 1878, mbi majën e një kodre të lartë që ngrihet në formën e një piramide. Kalaja gëzon statusin "pasuri kulturore" rikonfirmuar me urdhër nr. 482, datë 1.8.2023 të ministrit të Kulturës, si dhe VKM-së nr. 730, datë 13.12.2023, "Për deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme e zonave arkeologjike A dhe B të qytetit të Sarandës, Kalasë së Lëkurësit e Manastirit të 40 Shenjtorëve, dhe miratimin e zonimit e të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre".

Vendndodhja e pasurisë kulturore: lidhja 1.

3.1 Kriteret e konkurrimin

Personi fizik ose juridik, që kërkon të marrë në përdorim një pasuri kulturore publike, duhet të **përmblushë kriteret**, si më poshtë:

a) Personi fizik:

- të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e trashëgimisë kulturore;
- të jetë i regjistruar në regjistrat publikë;



iii. të mos jetë në procedura likuidimi dhe falimentimi;

iv. të ketë burimet e mjaftueshme financiare për marrjen në përdorim të pasurisë kulturore, publike, duke vërtetuar disponimin e kapaciteteve financiare për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e projektit;

v. të disponojë kapacitetet teknike dhe ligjore për të marrë përsipër përdorimin e pasurisë kulturore;

vi. të disponojë personelin e specializuar ose të sigurojë bashkëpunimin me persona të specializuar.

b) Personi juridik:

i. drejtuesi dhe/ose administratori të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e trashëgimisë kulturore;

ii. të ketë fituar personalitet juridik nëpërmjet regjistrimit në regjistrat publikë;

iii. të mos jetë në procedura likuidimi dhe falimentimi;

iv. të ketë burimet e mjaftueshme financiare për marrjen në përdorim të pasurisë kulturore publike, duke vërtetuar disponimin e kapaciteteve financiare për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e projektit;

v. të disponojë kapacitetet teknike dhe ligjore për të marrë përsipër përdorimin e pasurisë kulturore të paluajtshme, sipas formës së përdorimit të kërkuar;

vi. të disponojë personelin e specializuar ose të sigurojë bashkëpunimin me persona të specializuar.

Subjektet konkurruese, ndër të tjera, duhet të sigurojnë burime vjetore bazë për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e vlerave të paluajtshme kulturore mbi bazën e pronës nën rjetëzim dhe, në rastet kur janë të pranishme vlerat arkeologjike ose të dhëna rreth vendeve arkeologjike apo objekteve, edhe burime për studimet arkeologjike, deri në eksplorimin e plotë të zonës së pranuar.

4. Procedura

4.1. Lloji i procedurës

Procedurë konkurruese për dhënie në përdorim me qëllim rjetëzimi	Procedurë Konkurruese për dhënie në përdorim të drejtpërdrejtë
☒	☐

3.2. Për të provuar plotësimin e kriterëve të përgjithshme, subjektet e interesuara dorëzojnë dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore;

b) ekstrakt historik të regjistrimit të subjektit në regjistrat publikë;

c) dokumentacion financiar (vërtetim bankar i 3 (tre) muajve të fundit);

ç) dokumentacion tatimor, sipas përcaktimeve të komisionit në varësi të projektit;

d) dokumentacion teknik, sipas përcaktimeve të komisionit në varësi të projektit;

dh) vërtetim nga tatimet për numrin e punonjësve.

3. Dokumentacioni

Dosja e dorëzuar, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 3, duhet të përmbajë dhe dokumentet specifike, si më poshtë vijon:

i. propozimin për marrjen në përdorim të pasurisë kulturore;

ii. projektin e rjetëzimit, sipas nenit 185, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar;

iii. analizën e detajuar të projektit;

iv. planin e zhvillimit të territorit;

v. dokumentacionin për pjesëmarrje në projekte të mëparshme;

vi. garancinë për miradministrimin e pronës, në formën e një vërtetimi bankar, të 3 (tre) muajve të fundit nga data e dorëzimit të dokumentacionit, në vlerën jo më pak se 10 (dhjetë) % të projektit të propozuar;

vii. vërtetim për xhiron mesatare vjetore të 3 (tre) vjetëve të fundit, në vlerën prej minimalisht 50 (pesëdhjetë) % të vlerës së investimit të parashikuar në projektin e propozuar.



4.2 Kriteret e vlerësimit

Për dhënien në përdorim të pasurisë kulturore publike me qëllim rijetësimi, përveç kriterëve si më lart, vlerësohet:

Nr.	Kriteri	Pikët
1	Plani i kryerjes së ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, në varësi të objektit të veprimtarisë (plani i veprimit)	20
2	Niveli i investimit në raport me ruajtjen e promovimin e pasurisë kulturore	20
3	Cilësia e projektit të rijetësimit të propozuar, hartuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar	20

Pasuria kulturore publike jepet në përdorim, kur veprimtaria për të cilën jepet në përdorim:

Nr.	Kriteri	Pikët
1	Është në përputhje me funksionin dhe vlerat kulturore të pasurisë së miratuar, sipas vendimit të KKMPK-së	10
2	Promovon vlerat kulturore të pasurisë	10
3	Garanton shfrytëzimin e pasurisë kulturore në kuptim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe aksesin nga publiku	10
4	Ofron shërbime cilësore për publikun	10

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Dokumentacioni i kërkuar paraqitet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e botimit të njoftimit.

Data: 21.8.2025; Ora: 12:00

Vendi: Në ambientet e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Salla e Mbledhjeve, kati i katërt.

4.5 Gjuha/ët për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	☒	Shënim Dokumentacioni paraqitet në gjuhën shqipe, origjinal ose i njëzuar me origjinalin. Dokumentet nga shtetet e huaja paraqiten të legalizuara, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara sipas legjislacionit në fuqi.
-------	-------------------------------------	--

5. Informacione plotësuese

5.1. Shqyrtimi

Komisioni shqyrton e vlerëson dokumentacionin e paraqitur brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit të dorëzimit.

Mungesa e dokumenteve që vërtetojnë plotësimin e ndonjërit prej kriterëve të përcaktuara në kreun II të vendimit nr. 857, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të konkurrimit, formën dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturore publike, sjell skualifikimin e subjektit të interesuar. Ky fakt konstatohet në relacionin përfundimtar të komisionit.

Procesi i vlerësimit vazhdon edhe kur është paraqitur së paku një propozim i vlefshëm. Propozim i vlefshëm konsiderohet propozimi që nuk mund të skualifikohet, sipas parashikimeve të këtij vendimi.

Komisioni bën vlerësimin e projektit dhe të elementeve të tjera të konkurrimit, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 857, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të konkurrimit, formën dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturore publike”.

5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për dorëzimin e dokumentacionit)



Subjektet e interesuara për të marrë pjesë në konkurrimin publik dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm pranë protokollit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ose me postë fizike, ose elektronike, në adresën: info@meki.gov.al brenda datës 21.8.2025, ora: 12:00.

Ofertat do të hapen në ambientet e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Salla e Mbledhjeve, kati i katërt.


Data e shpërndarjes së këtij njoftimi: **21.7.2025.**



Lidhja 1







Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2025

